




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



Nr. 252/1 prot.

Shkodër, më 04.04.2025

Lënda: Mbi Vendimin nr. 10, datë 26.03.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz

*Elona*

### KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të nryshuar, neni 24, neni 53, pika 6, të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 21, të VKM nr. 597, dt. 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", i ndryshuar, të VKB Fushë Arrëz nr. 2, datë 27.01.2025 "Për miratimin e kritereve për përfitimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i ndihmës ekonomike i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2025", shqyrtoi VKB Fushë Arrëz nr. 10, datë 26.03.2025 "Për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Shkurt 2025 për njësitë administrative, Fushë Arrëz, Iballë, Qafë Mali, Blerim dhe Fierzë".

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni për trajtimin e 31 familjeve në shumën 122 451 lekë, duke përdorur deri në 6% të fondit total të ndihmës ekonomike prej 2 113 755 lekë për muajin Shkurt 2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ  
KËSHILLI BASHKIAK



*[Handwritten signature]*  
03/04/25

Nr. 906 prot.

Fushë-Arrëz, më 27. 03. 2025

## VENDIM

Nr. 10, datë 26. 03. 2025

### PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE PREJ 6% PËR MUAJIN SHKURT 2025 PËR NJËSITË ADMINISTRATIVE : FUSHË-ARRËZ, IBALLE, QAFË-MALI , BLERIM DHE FIERZË.**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore:”, i ndryshuar, neni 24, ligjit nr, 57/2019 ”Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.597.datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKM nr.85, datë 10.02.2021 “Për një shtesë në vendimin nr. 597. datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”; Udhëzimit të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 5, datë 17.2.2017 ”Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”, i ndryshuar ; VKM nr.868. datë 29.12. 2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 597. datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë mbi fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike”,VKB nr.2, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6%”, **Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz në mbledhjen e tij të datës 26.03.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga administratorët e ndihmës ekonomike të bashkisë Fushë-Arrëz,

### VENDOSI

Të miratojë listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok- ndihmës ekonomike deri në 6 % për muajin **Shkurt 2025** , 31 familje, me fond **126,825** lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën **2,113,755** lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në Shumën **122,451** lekë sipas Njësive Administrative:

## **NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR FUSHË-ARRËZ**

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin **Shkurt 2025**, 15 familje me një fond **52,401**lekë.

## **NJËSIA ADMINISTRATIVE IBALLE**

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin **Shkurt 2025**, 5 familje me një fond **20,136** lekë.

## **NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZË**

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin **Shkurt 2025**, 4 familje me një fond prej **21,602**lekë.

## **NJËSIA ADMINISTRATIVE QAFË-MALI**

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok -ndihmës ekonomike prej 6% për muajin **Shkurt 2025**, 4 familje me nje fond **13,999** lekë.

## **NJËSIA ADMINISTRATIVE BLERIM**

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin **Shkurt 2025**, 3 familje me një fond **14,313** lekë.

Bashkëlidhur tabelat e detajuara për çdo Njësi Administrative të bashkisë Fushë-Arrëz.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.

**Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:**

**9 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Zbardhur, më 27. 03. 2025.**

**SEKRETAR**

**Naze SELIMAJ**



**KRYETAR**

**Nikolin BARDHOKU**

